

RELACION SHPJEGUES

MBI

PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.497, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN RAJONAL DHE KOHEZIONIN (KKZHRK)”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Qëllimi i projektvendimit është bërja e shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr.497, datë 27.7.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”, lidhur me ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komitetit. Ky ndryshim ka për qëllim përcaktimin e një përbërje më të qartë të KKZHRK-së, bazuar në fushat e përgjegjësisë që ndërveprojnë me zhvillimin rajonal dhe kohezionin, duke siguruar qëndrueshmërinë e kësaj strukture ndaj ndryshimeve potenciale në konfigurimin dhe fushave të përgjegjësisë së ministrive përkatëse.

Përmes rishikimit të përbërjes dhe të organizimit të Komitetit Kombëtar të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit (KKZHRK) synohet përmirësimi i eficiencës institucionale dhe një funksionimi më koherent dhe efektiv të mekanizmave të koordinimit dhe vendimmarrjes në fushën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit.

II. VLERËSIM I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.497, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”

PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA.

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të miratuara për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME.

Projektvendimi synon rishikimin e përbërjes dhe të organizimit të Komitetit Kombëtar të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit (KKZHRK), me qëllim përmirësimin e eficiencës institucionale dhe funksionimit më koherent të mekanizmave të koordinimit dhe vendimmarrjes në fushën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit.

Rregullimi i propozuar mbështetet në faktin që përbërja e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) reflekton një konfigurim institucional të përfaqësimit në nivel qendror dhe vendor, për fushat kryesore që lidhen me zhvillimin rajonal sikundër përbërja e KKZHRK-së. Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, ku pesë anëtarë janë përfaqësues të pushtetit qendror, në nivel ministri/zëvendësministri dhe gjashtë anëtarët e tjerë janë përfaqësues të pushtetit vendor, nga të cilët dy janë kryetarë qarqesh të caktuar nga Shoqata e Kryetarëve të Këshillave të Qarqeve dhe katër janë kryetarë bashkie, të caktuar nga Shoqata e Kryetarëve të Bashkive.

Në këtë kontekst, rishikimi i përbërjes së KKZHRK-së synon harmonizimin institucional ndërmjet këtyre dy strukturave dhe do të krijojë një kuadër më të qartë dhe më funksional për koordinimin e politikave dhe instrumenteve financiare që lidhen me zhvillimin rajonal.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.497, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”

Gjithashtu, projektvendimi synon të rrisë fleksibilitetin institucional të KKZHRK-së në raport me ndryshimet e shpeshta në strukturën dhe portofolat e ministrive. Përvoja e viteve të fundit tregon se organizimi i kabinetit qeverisës dhe ndarja e përgjegjësive ndërmjet ministrive ka pësuar ndryshime të herëpashershme, çka ka sjellë nevojën për përshtatje të vazhdueshme të akteve nënligjore ku përcaktohen nominalisht institucionet përfaqësuese. Në këtë kuadër, VKM nr. 497, datë 27.7.2022, përcakton se anëtarët e KKZHRK-së janë në nivel zëvendësministri dhe përfaqësojnë fusha përgjegjësie që ndërveprojnë drejtpërdrejt me zhvillimin rajonal dhe kohezionin, konkretisht: financat dhe ekonominë, infrastrukturën publike, turizmin dhe mjedisin, mbrojtjen sociale, pushtetin vendor dhe decentralizimin, si dhe kulturën. Ky parashikim merrte parasysh konfigurimin e portofoleve ministrore në kohën e miratimit të VKM nr. 497, ndërkohë që si rrjedhojë e ndryshimeve të mëvonshme ka ndodhur riorganizimi i portofoleve ministrore. Këto ndryshime shkaktojnë mospërputhje dhe papërshtatshmëri në përfaqësimin e sektorëve apo linjave të përgjegjësive ministrore në KKZHRK, në raste të caktuara duke lënë jashtë përfaqësimit sektorë që luajnë rol relevant në orientimin e politikave dhe vendimmarrjes në lidhje me zhvillimin rajonal dhe në raste të tjera duke imponuar në mënyrë të zbalancuar përfaqësim të dyfishtë nga e njëjta ministri përderisa portofoli i saj mund të përfshijë fusha përgjegjësie që sipas parashikimit ekzistues në VKM nr.497 duhet të përfaqësohen në KKZHRK.

Në të njëjtën kohë, përbërja e re që propozohet për KKZHRK-së mbetet e harmonizuar me përbërjen e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, duke ruajtur koherencën institucionale ndërmjet dy strukturave që luajnë rol kyç në planifikimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal. Ky harmonizim është në përputhje edhe me frymën e ligjit nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, mbi bazën e të cilit është ngritur KKZHRK dhe synon të shmangë fragmentimin institucional, të forcojë koherencën vendimmarrëse dhe të krijojë një zinxhir më të unifikuar përgjegjësie në drejtim të politikave dhe instrumenteve financiare të zhvillimit rajonal. Nënvizojmë gjithashtu se rregullimi i Ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" në lidhje me përbërjen dhe përfaqësimin e aktorëve qëndrorë, rajonalë dhe vendor të zhvillimit rajonal në

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.497, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”

Këshillin Drejtues të FSHZH ka rezultuar efektiv dhe i qëndrueshëm, duke mundësuar funksionimin pa pengesa të tij, pavarësisht ndryshimeve dhe riorganizimeve të sistemeve ministrore përgjatë viteve. Për këtë arsye, propozimi për unifikimin e përbërjes së KKZHRK me atë të Këshillit Drejtues të FSHZH, përveç garantimit të një qasjeje të integruar politikëbërëse dhe vendimmarrëse në lidhje me zhvillimin rajonal, do të garantojë edhe stabilitetin dhe efektivitetin afatgjatë të KKZHRK.

Si rezultat, rishikimi i përbërjes dhe organizimit të KKZHRK-së pritet të krijojë një strukturë më të qëndrueshme institucionalisht, më të harmonizuar me mekanizmat ekzistues të menaxhimit të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe më të aftë për të garantuar koordinim efektiv ndërsektorial dhe menaxhim më të konsoliduar të politikave të zhvillimit rajonal dhe kohezionit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”. Projektvendimi është në përputhje dhe i harmonizuar me legjislacionin vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE

Projektvendimi nuk përfron në mënyrë specifike ndonjë akt të veçantë të Acquis Communautaire, por është në koherencë të plotë me paketën rregullatore të BE-së që rregullojnë zhvillimin rajonal dhe kohezionin ekonomik, social dhe territorial.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi përmban 5 (pesë) pika;

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.497, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”

Pika 1 parashikon se në kreun II pika 2 ndryshon me përmbajtje si vijon:

Pika 2, kreu II, bëhet ndryshimi duke cilësuar se KKZHRK-ja drejtohet nga Zëvendëskryeministri në cilësinë e kryetarit. Heqja e përcaktimit të numrit fiks të anëtarëve të KKZHRK-së, bëhet pasi përbërja e KKZHRK-së do të jetë e njëjtë me përbërjen e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) të emëruar sipas përcaktimeve të nenit 10 të Ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar.

Pika 2 parashikon se në kreun II pika 3 ndryshon me përmbajtje si vijon:

Pika 3, kreu II, ndryshohet duke hequr emërtimet e Ministrive që ndërveprojnë me zhvillimin rajonal dhe kohezionin për shkak të ndryshimeve të shpeshta në kabinetin qeveritar dhe strukturën e ministrive. Njëkohësisht, përbërja e KKZHRK-së do të jetë e njëjtë me përbërjen e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Anëtarë të KKZHRK-së janë anëtarët e Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), të emëruar sipas përcaktimeve të nenit 10 të Ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar. ”.

Pika 3 parashikon se në kreun II pikat 4, 5 dhe 7 shfuqizohen, në reflektim të përbërjes së re të KKZHRK-së.

Pika 4 parashikon një ndryshim në një aspekt të organizimit dhe teknikaliteteteve të mbledhjeve të KKZHRK-së.

Pika 10, kreu III, ndryshohet duke parashikuar se, në varësi të rendit të ditës, me propozim të kryetarit, mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e KKZHRK-së përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore, përfaqësues nga Bordet e Monitorimit të Zhvillimit Rajonal (BMZHR) të ngritura në përputhje me ligjin Nr.102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, përfaqësues të shoqatave të njësisive të vetëqeverisjes vendore, përfaqësues të donatorëve, të institucioneve të BE-së ose aktorë të tjerë të zhvillimit rajonal.

Pika 5 parashikon një ndryshim teknik;

Gërma a, parashikon një ndryshim të titullit të kreut i cili ndryshon si më poshtë vijon: “Dispozita të fundit”.

Shkronja b, shfuqizon pikat 1 dhe 2, të kreut V, në reflektim të rregullimit të ri të përbërjes së KKZHRK-së.

Shkronja c, pika 3 ndryshon duke ngarkuar Zëvendëskryeministrin, KKZHRK-në dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT

Vendimi do të zbatohet nga Zëvendëskryeministri, KKZHRK-ja, ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

VIII. MINISTRITË INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Projektvendimi është hartuar nga kabineti i Zëvendëskryeministrit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ALBANA KOÇIU

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.497, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”